

20131523597

LIGJ
PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TË OBLIGIMEVE SIPAS
MARRËVESHJES PËR HUA PËR PROJEKTIN "MODERNIZIMI I BLOKUT 1 NË TE
BITOLA", QË DO TË LIDHET NDËRMJET DOJÇE BANKËS DHE SHA ELEM

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton përmbushjen e obligimeve dhe plotësimin e dispozitave të Marrëveshjes për hua për projektin "Modernizimi i bllokut 1 në TE Bitola", që do të lidhet ndërmjet Dojçe Bankës dhe SHA ELEM në shumë prej 24 328 624,21 euro, nëse SHA ELEM nuk i plotëson dhe nuk i servison obligimet nga Marrëveshja për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji përcaktohen me Marrëveshjen për hua, që do të lidhet ndërmjet Dojçe Bankës dhe SHA ELEM për projektin "Modernizimi i bllokut 1 në TE Bitola".

Neni 3

Tërë obligimet që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas do ta kryejë SHA ELEM nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen për hua.

Neni 4

Huaja nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji do të paguhet në 24 këste gjysmëvjetore. Pagesa duhet të fillojë gjashtë muaj pas datës së gatishmërisë për punë të bllokut të modernizuar, e më së voni më 20 qershor 2015.

Shkalla e kamatës është shkallë variabile e kamatës që paraqet shumën EURIBOR gjashtëmujore plus margjina prej 1,295% vjetore.

Neni 5

Në afat prej 30 ditësh nga data e lidhjes së Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji, në mjetet e huas do t'i paguhet provizion i njehershëm Dojçe Bankës në shumë prej 0,575% të shumës së huas.

Në afat prej 30 ditësh nga data e lidhjes së Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji dhe në të njëjtën datë çdo vit të ardhshëm, në mjetet e huas në nivel vjetor do t'i paguhet provizion agentit të Dojçe Bankës në shumë prej 4 750 eurosh, derisa huaja nuk paguhet në tërësi.

Për shumën e mjeteve të patërhequra nga neni 1 i këtij ligji në nivel vjetor do t'i paguhet provizion Dojçe Bankës në shumë prej 0,625% të shumës së huas.

Provizioni nga paragrafi 3 i këtij neni do të paguhet në tremujor nga data e lidhjes së Marrëveshjes për hua.

Për obligimet lidhur me pagesën e huas nga neni 1 i këtij ligji që nuk do të paguhet në afatet e parapara, do të paguhet kamatë ndëshkuese në lartësi të shkallës së kamatës të rritur për 2% në vit.

Për obligimet tjera lidhur me pagesën e huas nga neni 1 i këtij ligji që nuk do të paguhet në afatet e parapara, do të paguhet kompensim i dëmit në lartësi të shkallës së kamatës të rritur për 2% në vit.

Neni 6

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella që dalin nga Marrëveshja për hua dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe SHA ELEM do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.